



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	prodate
Nr.	protnumber

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 9 QERSHOR 2021, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR CAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUESVE LIGJOR) DHE KUSHTET KONTRAKTUALE PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE GJATË VITIT KALENDARIK DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT E TYRE NË FUSHATËN ZGJEDHORE”, I NDRYSHUAR.

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pika 1, shkronja “ë” dhe 2, të ligjit 10019, datë 19.12.2008 “Kodi i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhur me të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore si dhe nxjerrjen e akteve administrative në këtë drejtim.

Nenet 92/6 dhe 92/7, të ligjit 10019, datë 19.12.2008 “Kodi i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktojnë auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore si dhe mënyrën e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) nga KQZ-ja.

Nenet 23/2 dhe 23/3, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, përcaktojnë mënyrën e caktimit të ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë), detyrimin e partive politike ndaj ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë), të cilët caktohen nga KQZ-ja, publikimin e raporteve të auditimit nga koha e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit si dhe mënyrën e pagesës së audituesve.

Në zbatim të neneve 19, pika 1, shkronja “ë” e 2, 92/6 dhe 92/7 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe neneve 23/2, 23/3, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, në kuadër të ndryshimeve ligjore është hartuar projekt-vendimi “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKVENDIMIT

Qëllimi i këtij projektvendimit është rishikimi i masës së shpërblimit për shërbimin e angazhimit e auditimit të audituesve ligjorë, në kuadër të ndryshimeve në sistemin e përgjithshëm të pagave në sektorin publik e privat që prej vitit 2021, kur edhe është përcaktuar kjo masë shpërblimi me Udhëzimin nr. 14/2021, i ndryshuar.

Bazuar në të dhënat zyrtare të marra nga Instituti i Statistikave¹, morëm 2 (dy) tregues të ndryshimit/rritjes së pagave:

- (1) Pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike, Tr.2.2021-Tr.1.2024; dhe
- (2) Pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grup-profesioneve, Tr.2.2021-Tr.1.2024.

Sipas treguesit të parë, rezulton se për aktivitetin: aktivitete financiare dhe të sigurimit, paga mesatare mujore bruto në tremujorin e parë të vitit 2024 është në vlerën 133,982 lekë, ndërsa në tremujorin e dytë të vitit 2021 (kur është përcaktuar masa e shpërblimit: Udhëzimi nr. 14/2021) ka qenë në vlerën 120,571 lekë, pra është rritur me 11.1%.

Sipas treguesit të dytë, rezulton se për grup-profesionin: specialistë me arsim të lartë (profesionistë), paga mesatare mujore bruto në tremujorin e parë të vitit 2024 është në vlerën 95,307 lekë, ndërsa në tremujorin e dytë të viti 2021 (kur është përcaktuar masa e shpërblimit: Udhëzimi nr. 14/2021) ka qenë në vlerën 76,375 lekë, pra është rritur me 20.5%.

Përgjatë këtyre 3 (tre) viteve, si KQZ kemi konstatuar se interesi i audituesve ligjorë për të marrë pjesë në këtë proces ka ardhur duke rënë dhe numri i aplikimeve ka qenë i pakët edhe për shkak të masës së shpërblimit që sipas edhe kërkesave të tyre do duhej të rishikohej.

Për të siguruar mbarëvajtjen e këtij procesi, dhe shpërblim sa më të drejtë për këta profesionistë, duke u bazuar në rritjen në përqindje sipas treguesit të dytë (paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grup-profesioneve, Tr.2.2021-Tr.1.2024), propozojmë që si për auditimin vjetor të partive politike ashtu edhe për raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për fushata zgjedhore, çmimi i shërbimit të rritet nga masa 0.3 % në $0.3 + 0.3 \cdot 20.5\%$ (e rrumbullakosur në të mjitën më të afërt), pra 0.4% të vlerës të të ardhurave të subjektit të audituar (pa TVSH), ku vlera e të ardhurave do të jenë të gjitha hyrjet të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta. Sa i takon rastit kur çmimi i shërbimit është nën vlerën referuese të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, përcaktuar me vendim të

¹ <https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pagat/#tab2>

Këshillit të Ministrave, audituesi do të vijojë të paguhet sa paga minimale, pasi kjo pagë gjithsesi është rritur me Vendim Qeverie nga viti 2021 në 2024 përkatësisht nga 30,000 lekë në 40,000 lekë pra në masën 30%. Efektet financiare në buxhetin e shtetit që burojnë nga ky ndryshim i masës së shpërblimit do të përballohen nga buxheti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në rastin e auditimeve për shpenzimet dhe të ardhurat për fushatë zgjedhore dhe do të përballohet nga partitë politike në rastin e raportimeve financiare vjetore.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si dhe ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, shqyrton dhe miraton projekt-vendimi “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.

Jona JOSIFI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me autorizim)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data:

Nr:

Ora: 00

VENDIM
PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 9.6.2021, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR CAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUESVE LIGJOR) DHE KUSHTET KONTRAKTUALE PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE GJATË VITIT KALENDARIK DHE SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE KANDIDATËT E TYRE NË FUSHATËN ZGJEDHORE, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 19 pikat 1, shkronja “ë”, e 2, 92/6 pika 3, dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 23/2 e 23/3, të ligjit nr. 8580 datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, të ndryshuar,

VENDOS:

- I. Në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:
1. Pika 1, e nenit 4, të kontratës së shërbimit për auditimin vjetor të partive politike që referohet në pikën 8, të nenit 6 (shtojca nr. 1), ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 4

Çmimi i shërbimit

1. Ofruesi i Shërbimit do të paguhet në masën 0.4%, në bazë të vlerës të të ardhurave të subjektit të audituar (pa TVSH). Vlera e të ardhurave do të jenë të gjitha hyrjet të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.”

Data: 0..0. 2024 Nr:
Ora: 00:00



“Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”

2. Pika 1, e nenit 4, të kontratës së shërbimit për auditimin e fushatës zgjedhore që referohet në pikën 8, të nenit 6 (shtojca nr. 2), ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 4
Çmimi i shërbimit

1. Ofruesi i Shërbimit do të paguhet në masën 0.4%, në bazë të vlerës të të ardhurave të subjektit të audituar (pa TVSH). Vlera e të ardhurave do të jenë të gjitha hyrjet të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

Kopje 3
Afati i ruajtjes 5 vjet
Konceptoi: E. Podgorica _____
Miratoi K. Puleri _____
Aprovoi: J. Josifi _____
 M. Koja _____
 M.Çelmeta _____

Data: 0.0.2024 Nr:
Ora: 00:00



“Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”